



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONERI PËR TË DREJTEN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN  
E TË DHËNAVE PERSONALE

Nr. 536/5 Prot

Tiranë, më 13/07/2015

V E N D I M

Nr. 36, datë 13/07/2015

Në mbështetje të neneve 29, 30 dhe 32 të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*" i ndryshuar, Ligjit nr. 8485, datë 12/05/1999 "*Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë*" dhe provave të administruara në ngarkim të kontrolluesit "*Biemme Contact Center*" sh.p.k., *Shkodër*,

V Ë R E J S E :

Në zbatim të Urdhrit nr. 132 datë 01/06/2015, është kryer hetim administrativ pranë subjektit kontrollues "*Biemme Contact Center*" sh.p.k, me objekt: Plotësimi i detyrimit për njoftim, në zbatim të nenit 21 të Ligjit nr. 9887 dt. 10/03/2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*", i ndryshuar.

Kontrolluesi, gjatë ushtrimit të aktivitetit mbledh, përpunon dhe ruan të dhëna personale për subjektet e të dhënave të cilët kanë lidhje me aktivitetin e tij. Nga hetimi administrativ i ushtruar pranë kontrolluesit dhe provat e administruara, rezultoi se "*Biemme Contact Center*" sh.p.k. nuk e ka përmbyshur detyrimin ligjor për të njoftuar pranë Zyrës së Komisionerit (neni 21) deri në momentin e ushtrimit të hetimit administrativ. Për shkeljen e konstatuar është mbajtur procesverbali i konstatimit në momentin e ushtrimit të kontrollit administrativ. Mbas shkeljes së konstatuar nga grupi i hetimit administrativ, përfaqësuesi i kontrolluesit ka paraqitur në procesverbal pretendimin se: "*Nuk ka patur dijeni për sa i përket këtij ligji por, angazhohet për zbatimin e tij*".

Ligji nr. 9887 datë 10/03/2008, "*Për mbrojtjen e të dhënave personale*" i ndryshuar, është miratuar dhe botuar në Fletoren Zyrtare dhe me kalimin e afatit ligjor përkatës, është bërë i njohur për të gjithë publikun dhe është i detyrueshëm për zbatim. Nga miratimi i këtij ligji deri në momentin e ushtrimit të këtij hetimi administrativ ka kaluar një kohë relativisht e gjatë dhe kontrolluesi ka patur gjithë mundësinë për t'u njohur me ligjin dhe detyrimet përkatëse, për më tepër që ka lidhje të drejtpërdrejtë me aktivitetin e tij. Mosnjohja e ligjit, nuk përbën shkak ligjor për përjashtimin nga përgjegjësia e përmbyshjes së detyrimeve ligjore nga kontrolluesi.

Në respektim të së drejtës për t'u dëgjuar përpara marrjes së vendimit përfundimtar (pavarësisht, se subjektit kontrollues i është dhënë mundësia edhe nëpërmjet procesverbalit



të konstatimit të paraqes pretendimet e tij), si dhe në zbatim të neneve 93-96 të ligjit nr. 8485, datë 12/05/1999 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", është kërkuar dy herë të njoftohet nëpërmjet postës zyrtare kontrolluesi "Biemme Contact Center" sh.p.k. për t'u paraqitur pranë ambienteve të zyrës së Komisionerit, por shkresat janë kthyer pa u marrë në dorëzim nga subjekti "Biemme Contact Center" sh.p.k. Në pamundësi për të njoftuar nëpërmjet postës zyrtare është angazhuar vetë zyra e Komisionerit për të dorëzuar shkresën dorazi në ambientet e kontrolluesit. Punonjësi i zyrës së Komisionerit ka kontaktuar në vend përfaqësuesin e kontrolluesit, i cili ka refuzuar të marrë në dorëzim njoftimin për të marrë pjesë në seancë dëgjimore. Pavarësisht refuzimit për të marrë në dorëzim dorazi postën, punonjësi i zyrës së Komisionerit e ka informuar verbalisht përfaqësuesin e kontrolluesit lidhur me datën dhe orën e seancës dëgjimore. Kontrolluesi "Biemme Contact Center" sh.p.k nuk është paraqitur në datën dhe orën e përcaktuar dhe njoftuar për seancën dëgjimore, (edhe pse ka marrë njoftim disa herë edhe në rrugë telefonike). Korrespondenca e sipërcituar është e depozituar në cilësinë e provës materiale në dosjen përkatëse të hetimit administrativ në emër të kontrolluesit.

Nga verifikimi në regjistrin elektronik të zyrës së Komisionerit deri në momentin e daljes së këtij vendimi, rezultoi se kontrolluesi "Biemme Contact Center" sh.p.k, ende nuk ka përmbushur detyrimin ligjor për njoftim pranë Zyrës së Komisionerit, sipas detyrimeve të parashikuara në nenin 21 të ligjit, duke treguar mungesë të theksuar vullneti për përmbushjen e detyrimeve ligjore dhe mungesë bashkëpunimi me Zyrën e Komisionerit, si institucion shtetëror.

Sipas Ligjit nr.9887, datë 10/03/2008, "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar, kontrolluesit kanë përgjegjësinë për përpunimin e të dhënave personale të subjekteve të të dhënave e për pasojë, detyrimin e zbatimit e të gjitha kërkesave të këtij ligji, në mënyrë të veçantë, atë të detyrimit që parashikon paragrafi 1 i nenit 21: "...Çdo kontrollues duhet të njoftojë komisionerin për përpunimin e të dhënave personale, për të cilat është përgjegjës. Njoftimi duhet të bëhet para se kontrolluesi të përpunojë të dhënat për herë të parë ose kur kërkohet ndryshimi i gjendjes së njoftimit të përpunimit, sipas nenit 22 të këtij ligj".

Bazuar në nenin 25/1 të ligjit, kontrolluesi nuk mund të fillojë përpunimin e të dhënave personale pa njoftuar më parë Zyrën e Komisionerit. Në këto kushte, konsiderohet shkelje serioze përpunimi i të dhënave personale, pa njoftuar dhe pa u regjistruar më parë në Regjistrin Qëndror të subjekteve kontrolluese, të administruar nga Zyra e Komisionerit.

Si përfundim, shkelja e konstatuar gjatë ushtrimit të kontrollit administrativ në kuptim të nenit 39/1 shkronja "d" të ligjit nr. 9887 datë 10/03/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, përbën "kundërvajtje administrative" dhe sanksionohet me gjobë, si më poshtë:

- Kontrolluesit, që nuk përmbushin detyrimin për të njoftuar, sipas përcaktimit në nenin 21 të këtij ligji, dënohen me gjobë në vlerën 10 000 deri në 500 000 lekë;

Kontrolluesi është person juridik dhe bazuar në nenin 39 /2 dënohet me dyfishin e gjobës për shkeljen e konstatuar.

Për zgjedhjen e masës së gjobës, Zyra e Komisionerit ka parasysh faktin se shkelja e konstatuar është serioze, ajo lidhet me të drejtën e subjekteve të të dhënave personale për t'u informuar se kush përpunon të dhëna personale, informimin si një e drejtë parësore në zbatim të ligjit dhe parim bazë i mbrojtjes së të dhënave personale. Gjithashtu, bazohet në mungesën e bashkëpunimit gjatë ushtrimit të hetimit administrativ si edhe reagimin e

kontrolluesit për rikuperimin e shkeljes së konstatuar. Zyra e Komisionerit, ka parasysh mungesën e theksuar të vullnetit të kontrolluesit për përmbushjen e detyrimit ligjor, faktin që ky detyrim ende nuk është plotësuar edhe pse kontrolluesi ka marrë dijeni për plotë për detyrimin ligjor të përmbushjes së tij si edhe mungesën e bashkëpunimit me Zyrën e Komisionerit, si institucion shtetëror që garanton zbatimin e ligjit.

### PËR KËTO ARSYE :

Në zbatim të neneve 21, 30, 31, 32/1, 39/1/d, 39/2, 40 dhe 41 të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar,

### V E N D O S A :

1. Dënimin e kontrolluesit "**Biemme Contact Center**" sh.p.k., Shkodër, me gjobë në vlerën 400.000 (katërqindmijë) lekë.
2. Plotësimin e detyrimit për njoftim pranë Zyrës së Komisionerit brenda 5 (pesë) ditëve nga data e njoftimit të këtij vendimi.
3. Gjoha arkëtohet nga kundërvajtësi në Buxhetin e Shtetit, jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë nga komunikimi i këtij vendimi. Me kalimin e këtij afati, ky vendim kthehet në titull ekzekutiv dhe ekzekutohet në mënyrë të detyrueshme nga zyra e përmbartimit.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në gjykatën administrative kompetente, në afatet dhe sipas procedurave që rregullojnë gjykimin administrativ, në përputhje me nenin 40 të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar.

Ky vendim u shpall sot në 3/07/2015

**Besnik DERVISHI**

